



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri: KSC-CC-PR-2017-01

Vendosi: Kryetarja e Dhomave të Specializuara
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 27 mars 2017

Titulli: Referim i Rregullores së Procedurës dhe të Provave
bazuar në nenin 19 (5) të Ligjit

PUBLIK me Shtojcë Konfidenciale

REFERIM

**i Rregullores së Procedurës dhe Provave, Dhomës së Specializuar të Gjykatës
Kushtetuese**

KRYETARJA e Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”), duke vepruar në bazë të nenit 19(5) të Ligjit Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”), me anë të këtij vendimi, i referon Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, Rregulloren e Procedurës dhe të Provave (“Rregullorja”).

1. Më 17 mars 2017, gjykatësit e Dhomave të Specializuara të mbledhur në seancë plenare (“Plenare”), me përjashtim të gjykatësve të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, miratuan Rregulloren.
2. Në nenin 19(5) të Ligjit përcaktohet se pas miratimit, Rregullorja i referohet Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese për të garantuar përputhshmërinë e saj me Kapitullin II, përfshirë edhe nenin 55 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

PËR ARSYET E LARTPËRMENDURA, dhe në përmbushje të përgjegjësisë së vet për administrimin gjyqësor të Dhomave të Specializuara në bazë të nenit 32(3) të Ligjit,

NË VIJIM, KRYETARJA

i referon Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, Rregulloren e Procedurës dhe të Provave që i bashkëngjitet Shtojcës Konfidenciale, për të garantuar përputhshmërinë e Rregullores me Kapitullin II, duke përfshirë edhe nenin 55 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova,
Kryetare e Dhomave të Specializuara

E hënë, 27 mars 2017

Në Hagë, Holandë.